



**VENDIM**

Nr. 41, Datë 31/10 /2017

Për

**"Miratimin e rishpërndarjes së kuotave në disa programe studimi, të kandidatëve fitues në konkurset e pranimit në ciklin e dytë të studimeve më kohë të plotë Master i Arteve dhe Master Profesional në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2017 – 2018"**

Në zbatim të nenit 3; të nenit 69; të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresës me Nr. 441 Prot., datë 23.10.2017 të Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik (Nr. 1471 Prot., datë 23.10.2017 të UA) me lëndë "Kërkesë për rialokim kuote për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve Master i Arteve" si dhe shkresës më Nr. 405/1 Prot., datë 20.10.2017 të Dekanit të Fakultetit të Muzikës (Nr. 1479 Prot., datë 24.10.2017 të UA) "Kërkesë për rialokim kuote në programin e studimit "Master Profesional në Pedagogji Muzikore dhe program i dytë studimi "Master i Arteve" në Trombë"

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rishpërndarjes së kuotave brenda numrit të përgjithshëm të kuotave të miratuara për vitin akademik 2017-2018, si më poshtë:
  - I. **Skenografi-Kostumografi** 1 kuotë program i dytë studimi, duke rishpërndarë kuotën për program të dytë studimi në Aktrim Master i Arteve;
  - II. **Trombë** 1 kuotë program i dytë studimi Kosovë, duke rishpërndarë kuotën për program të dytë studimi në Muzikologji Master i Shkencave;
  - III. **Pedagogji Muzikore** 6 kuota program i dytë studimi, duke rishpërndarë kuotat për program të parë studimi 3 kuota në Pedagogji Muzikore, Master Profesional, për program të parë studimi 1 kuotë në Fizarmonikë Klasike, Master Profesional, për program të parë studimi 1 kuotë në Bas-tubë, Master Profesional, për program të parë studimi 1 kuotë në Kitarë, Master Profesional.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik, Sekretariatë mësimore të fakulteteve dhe Sektori mësimor dhe informimit të studentëve;
3. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve;
4. Vendimi të dërgohet për njoftim dhe miratim Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për këto rishpërndarje.

**Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.**



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Nansy GJERAZI

Rafael HOXHA